



Tirane, me 15.07.2020

**VENDIM**

**Nr. 14 Date 15.07.2020**

**PER**

**MIRATIMIN E OFERTËS AKADEMIKE DHE TARIFAVE TË STUDIMEVE PËR VITIN  
AKADEMIK 2020-2021.**

Bordi i Administrimit të KUB mbledhur në datën 15.07.2020 në ambientet e "Kolegjit Universitar të Biznesit" Tiranë, pasi diskutoi për fillimin e punës, politikën e pranimit të studentëve, politikën e tarifave të studimit dhe përfitimeve shtesë të lidhura me pranimet e vitit akademik 2020-2021,

**VENDOSI:**

**1. OFERTA AKADEMIKE E KUB, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 TË  
JETË SI MË POSHTË:**

- Kolegji Universitar i Biznesit pranon kandidatë-studentë për të TRE Ciklet e studimit:  
Studime të Larta Profesionale 2 vjeçare
  - Studime 3 vjeçare Bachelor në 3 programe FE, 6 Degë/Profile dhe
  - Studime në Master profesional e Master i shkencave në 6 (gjashtë) programe.
  - Studime të integruara 5 vjeçare në Drejtësi.
- KUB, pranon studentë në Ciklin Bachelor me note mesatare mbi 6,5 dhe në Kolegjin Për Studime të Larta Profesionale 2 vjeçare, me 2 Programe dhe 6 Profile, për maturantët që nuk plotësojnë Kriterin e notes 6.5.

**2. OFERTA FINANCIARE E KUB PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 TË JETË  
SI MË POSHTË:**

Tarifat vjetore, për ndjekjen e studimeve pranë këtij Institucioni do të jenë:

1. Për Ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, për të dy Fakultetet, është 1.600 Euro/vit.  
(Kjo ofertë vlen edhe për vitet e tjera, deri në përfundim të programit të studimeve për studentin e regjistruar këtu vit).
2. Studentët që regjistrohen në vitin e parë në programet bachelor dhe kanë përfunduar me rezultate të larta shkollën e mesme përfitojnë  
**Bursa studimi, si më poshtë:**
  - a. Me notë mesatare mbi 9 pranohen me Bursë të plotë (pa pagesë).
  - b. Me notë mesatare mbi 8 përfitojnë Gjysmë Burse.
3. Studentet që regjistrohen në Kolegjin Për Studime të Larta Profesionale 2 vjeçare, e kanë Tarifen Vjetore të studimeve 1600 Euro/viti.
4. Për nevoja social ekonomike, Presidenti dhe Administratori aplikojnë me shkrim tarifa të reduktuara.
5. Për pararegjistrime aplikohet ulje tarife për 25%.

6. Studentët që regjistrohen sipas pikave më sipër dhe bëjnë pagesën e tarifës njëherësh edhe për vitet pasardhese, për këto vite ata përfitojnë një zbritje në masën 10%.
7. Studentet e bachelorit të KUB që vijojnë studimet në Master përfitojnë ulje 100-200 euro në vit.
8. Në përputhje me situatën e krijuar gjatë procesit të regjistrimeve, kur gjykohet e nevojshme, për të nxitur regjistrimet, Presidenti dhe Administratori, mund të aplikojnë Oferta financiare deri 25% më të ulta nga Tarifa normale.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Përzbatimin e tij ngarkohen Fakultetet, Sekretariatë përkatëse dhe Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar.

**KRYETARI**

**Prof. Dr. Alfred MULLAJ**

